



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2354, datë 27.09.2013

Për

**“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve
Albtelecom Sh.A., dhe Vodafone Albania Sh.A.”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Znj. Alketa Mukavelati	Kryetare
2. Z. Alban Karapici	Anëtar
3. Z. Benon Paloka	Anëtar
4. Znj. Elkeda Domi	Anëtare
5. Znj. Zamira Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Mirela Xhelaj, në mbledhjen e datës 27. 09. 2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 102.2012, datë 34. 10. 2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 8480, datë 27. 05. 1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Albtelecom Sh.A., dhe Vodafone Albania Sh.A., me marrjen e kërkesës nga sipërmarrësi Albtelecom Sh.A., me shkresë Nr. 5880 Prot., datë 25. 09. 2013 “Kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje me Vodafone Albania”.

BAZA LIGJORE

1. Shkronja n) e nenit 8, pika 1e nenit 114, pikat 1 dhe 2 të nenit 115 dhe neni 120 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 9918*);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12. 05. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*KPrA*);

3. Rregullore nr. 18, datë 11. 06. 2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP-it nr. 1296, datë 11. 06. 2010 (*Rregullorja 18/2010*).

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- Shkresë Nr. 5880 Prot, datë 25. 09. 2013 “Kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje me Vodafone Albania”, të sipërmarrësit Albtelcom Sh.A, së bashku me informacionin sipas Shtojcës 1 dhe shkresat:
- Shkresa e Vodafone me Ref. CEO/113/MF datë 15.9.2013 “Mbi njoftimin e tarifës së terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e Vodafone”;
- Shkresa e Albtelcom me nr. 5644/1Prot, datë 19.9.2013 “Përgjigje tuajës datë 16.9.2013 ref: CEO/113/MF “Mbi njoftimin e tarifës së terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e Vodafone””;
- Shkresa e Vodafone me Ref. CEO/114/MF datë 20.9.2013 “Kthim përgjigje shkresës tuaj të datës 19.9.2013, nr. 5644/1Prot.”;
- Relacionit të paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Rregullimit Ekonomik: “*Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelcom sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a. në lidhje me tarifën e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara nga rrjeti i Albtelcom sh.a. drejt abonentëve të Vodafone Albania sh.a.*”;

duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipër cituar, akteve të nxjerra nga AKEP-i:

- Vendim nr. 1740, datë 20. 12. 2011 për “Shfuqizimin e VKD nr.1437 datë 3.11.2010 “Për disa ndryshime në VKD nr. 1347, datë 23.07.2010 “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone sh.a për ndryshim të aktit administrativ, Vendim nr.1211, datë 31.03.2010 të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese””;
- Vendim Nr. 1886, datë 19. 04. 2012 për “Disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.A.” ;
- Vendim nr. 1934, datë 07. 05. 2012 për “Disa korrigjime në VKD nr. 1886, datë 19. 04. 2012 të AKEP “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.A.;
- Vendim nr. 2122, datë 04. 07. 2012 për “Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.A., me Fuqi të ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”;

si dhe,

- Marrëveshje e Interkoneksionit midis Vodafone Albania Sh.A., dhe Albtelecom Sh.A. “Për Shërbimet e Rrjetit të Telefonisë së Levizshme”, depozituar në AKEP me Nr. 3707 Prot., datë 1. 7. 2013 (*MI 3707/2013*);

VËREN:

I. Me shkresë Nr. 5880 Prot., datë 25. 09. 2013 “Kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje me Vodafone Albania” të sipërmarrësit Albtelecom Sh.A., si organ kompetent në mbështetje të shkronjës n) të nenit 8 dhe 120 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 9918*), viheti në dijeni dhe investohemi nga ky sipërmarrës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së lindur midis sipërmarrësve Albtelecom Sh.A., dhe Vodafone Albania Sh.A., lidhur me njoftimin për aplikimin e tarifës së re të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e Vodafone Albania, njoftuar me shkresën referenca e Vodafone Albania CEO/113/MF, datë 16. 09. 2013 dhe konsekuencat e mosdakortësisë për pranimin e kësaj tarife nga pala tjetër.

1. Në lidhje me mosmarrëveshjen

Albtelecom sqaron se, që prej datës 11 maj 2011 deri më datë 31 gusht 2013, kjo tarifë ka qenë e barabartë me tarifën e shërbimit të terminimit të thirrjeve hyrese kombëtare në rrjetin e Vodafone, të përcaktuar nga AKEP. Nga data 1 shtator 2013 tarifa e shërbimit të terminimit të thirrjeve hyrëse kombëtare në rrjetin e Vodafone është 4,57 lekë/min.

Albtelecom sqaron se më datë 16 shtator 2013, me shkresën CEO/113/MF, Vodafone e ka njoftuar se prej datës 23 shtator 2013 tarifa e re e terminimit në rrjetin e Vodafone për thirrjet ndërkombëtare do të jetë në vlerën 27,4 lekë/min ose 6 herë më e madhe se tarifa e terminimit për thirrjet kombëtare.

Albtelecom me shkresën nr. 5644/1Prot, datë 19.9.2013, nuk e ka pranuar tarifën e re të propozuar nga Vodafone duke kërkuar të njëjtën tarifë terminimi pavarësisht

2. Marrëveshja e interkoneksionit (MI) në fuqi

Albtelecom shpjegon se, Vodafone dhe Albtelecom kane nënshkruar Marrëveshjen e Interkoneksionit nr. 3565, datë 4.8.2011, e cila është amenduar disa herë. Amendamenti 3, i datës 11.5.2012, (është i fundit) dhe në nenin 7.2 të tij thuhet: “*Tarifat e shërbimeve të interkoneksionit mund të ndryshohen në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9918 dhe kuadrin rregullator përkatës*”.

Në nenin 32.1, thuhet: “*Ndryshimi i tarifave që nuk janë objekt rregullimi nga AKEP, hyjnë në fuqi pa miratimin e AKEP, për sa kohë AKEP nuk shprehet me vendim për mosmiratimin/pezullimin e ndryshimit të tyre*”.

Albtelecom shpjegon se, Vodafone mund të ndryshojë tarifën e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara nga Albtelecom drejt rrjetit të abonentëve të Vodafone, me kusht që tarifa e ndryshuar të jetë në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9918.

3. Zgjidhja e njëanshme e MI

Albtelecom shpjegon se për mosdakortësinë mbi tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e Vodafone, Vodafone i ka njoftuar Albtelecom refuzimin e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare. Ky refuzim aksesit shprehet Albtelecom është një zgjidhje e njëanshme e pjesshme e Marrëveshjes së Interkoneksionit.

Albtelecom sqaron se asnjë nga nenet e MI nuk parashikon që Vodafone mund të zgjidhë në menyrë të pjesshme MI sepse Albtelecom nuk pranon ndryshimin e njëanshem të tarifës së terminimit të thirrjeve ndërkombëtare (*referencë nenet e MI: 19; 19.1; 19.2; 19.4; 19.5; 20; 20.5; 20.5.4*)

Albtelecom për sa më lart sqaron se, ka të drejtë të ankohet në AKEP mbi tarifën e propozuar nga Vodafone, dhe ky i fundit ka detyrim të negociojë për një periudhë 10 ditore çdo mosmarrëveshje. Dhe në çdo rast palët i drejtohen AKEP për zgjidhje të momarrëveshjes.

Albtelecom shpjegon se ndërprerja e shërbimit të terminimit të trafikut ndërkombëtar, bllokimi i kapaciteteve të interkoneksionit të dedikuara terminimit të trafikut ndërkombëtar të tranzituar nga Albtelecom 7 ditë pas njoftimit të tarifës së re të rritur 6 herë, është një shkelje flagrante e MI dhe Albtelecom është i vendosur të kërkojë shpërblimin e e te gjithë dëmeve të shkaktuar, duke përfshirë edhe fitimin e munguar, dëmin e shkaktuar reputacionit dhe emrit të mirë të Albtelecom.

Albtelecom shprehet se, Vodafone është në shkelje të neneve 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 9918, të neneve 4 e 6 të “*Rregullores për akses e interkoneksion*” dhe gjithashtu edhe të Marrëveshjes së Interkoneksionit (*kontrata*) e lidhur mes palëve.

4. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve

Albtelecom, i referohet historikut të masave rregullatore të ndërmarra nga AKEP gjatë viteve 2010 – 2012, bazuar në Rregulloren nr. 9, datë 17.7.2009, “*Për analizën e tregut të telefonisë së lëvizshme*” e ndryshuar dhe shprehet se, lidhur me heqjen e masave rregullatore për rregullimin “*ex-ante*” të tarifës së terminimit të thirrjeve ndërkombëtare pavarësisht nga statusi FNT i çdo operatori celular në tregun e terminimit në rrjetin e tij, është bërë nga AKEP sepse tregu është vetërregulluar dhe operatorët kanë dakortësuar mbi tarifën nëpërmjet negociatave komerciale. Kështu ka qenë edhe MI e lidhur mes Albtelecom dhe Vodafone.

II. Procesi i trajtimit të liberalizimit të marrëdhënieve midis sipërmarrësve lidhur me shërbimin e tranzitimit dhe terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, duke nënkuptuar këtu heqjen nga rregullimi të tarifave të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare dhe vendosjes e tyre mbi bazën e lirisë kontraktuale, ka qenë një proces i gjatë, i vështirë dhe me një qëndrime të kundërta midis vetë operatorëve, të shprehur gjatë proceseve të këshillimeve publike mbi dokumentat rregullatore të nxjerra nga AKEP-i për këtë çështje.

Me Vendim nr. 1740, datë 20. 12. 2011 për ““Shfuqizimin e VKD nr.1437 datë 3.11.2010 “Për disa ndryshime në VKD nr. 1347, datë 23.07.2010 “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone sh.a për ndryshim të aktit administrativ, Vendim nr.1211, datë 31.03.2010 të AKEP

“Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, pasuar ky edhe me vendimet Nr. 1886, datë 19. 04. 2012, Nr. 1934, datë 07. 05. 2012, Nr. 2118, datë 04. 07. 2012, Nr. 2122, datë 04. 07. 2012 të Këshillit Drejtues të AKEP-it lidhur me zbatimin e tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, është vendosur nxjerrja jashtë rregullimit të këtyre tarifave dhe vendosja e tyre nga palët në marrëveshje mbi bazën e respektimit të lirisë kontraktuale.

Por në pjesën aryetuese të VKD Nr. 1740, nga AKEP-i është arsyetuar dhe kërkuar që “**Tarifat e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të vendosen nga palët në marrëveshje mbi bazën e respektimit të parimit të lirisë kontraktuale dhe të proporcionalitetit të interesave reciproke komerciale për të mos shkaktuar dëm të shpërpjestuar të interesave të tyre**”. Kjo nënkupton që palët (sipërmarrësit) pamvarsisht faktit të gëzimit të lirisë kontraktuale për vendosjen e tarifave të terminimit për thirrjet hyrëse ndërkombëtare në rrjetet reciproke, lidhur me vendosjen e nivelit të tyre duhet të rrespektojnë rigorozisht parimin e proporcionalitetit të interesit reciprok, me qëllim ruajtjen e një interesi të përbashkët komercial dhe jo të njëanshëm e përjashtues. Niveli i tarifave të ofruara dhe të aplikuara të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare midis sipërmarrësve brenda lirisë së interesit tregtar duhet në çdo rast të ruajnë kufijtë e një interesi reciprok, natyrisht proporcional të pranueshëm nga palët dhe jo përjashtues dhe në masë të tillë që të çënojë rëndë interesat e palës tjetër.

Situata konfliktuale e krijuar midis dy sipërmarrësve me peshë në tregun e komunikimeve elektronike në vend, ka arritur deri në bllokimin e plotë nga ana e Vodafone Albania të kapacitetit të interkoneksionit të dedikuar për terminimin e trafikut ndërkombëtar të tranzituar nga Altelecomi për shkak të mospranimit nga ana e tij të tarifës së ofruar nga Vodafone Albania në nivelin 27,4 lek/min. Në materialin shkresor nuk konstatohen argumenta që të justifikojnë reciprokisht midis palëve, interesin tregtar për aplikimin e kësaj tarife në nivelin 27,4 lek/min.

III. Bllokimi i plotë nga ana e Vodafone Albania të kapacitetit të interkoneksionit të dedikuar për terminimin e trafikut ndërkombëtar të tranzituar nga Altelecomi sjell për pasojë dështimin e tërë thirrjeve të origjinuara nga bota në adresë të pajtimtarëve të rrjetit të Vodafone Albania çka përbën një çënim të rëndë të interesave të tyre.

Gjithashtu, në pikën 32.1 të MI 3707/2013 parashikohet se ndryshimi i tarifave që nuk janë objekt rregullimi nga AKEP, hyjnë në fuqi pa miratimin e AKEP, për sa kohë AKEP nuk shprehet me vendim për mosmiratimin/pezullimin e ndryshimit të tyre.

Ndërsa, neni 78 i KPrA parashikon që “Organi administrativ që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar, mund të marrë edhe vendime të ndërmjetme kur gjykohet se mosmarrja e masave të caktuara do të sillte si pasojë shkaktimin e një dëmi të rëndë e të pariparueshëm mbi interesat publike”.

KPrA dhe rregullore 18/2010, për mbylljen e procedimit administrativ dhe marrjen e vendimit përfundimtar nga organi administrative, përcakton një afat deri në 90 ditë nga data e fillimit të procedurës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Duke patur parasysh rrethanat e krijuara për shkak të mosmarrëveshjes, nëse nuk do të merren masat e nevojshme rregullatore të ndërmjetme deri në marrjen e vendimit përfundimtar për mbrojtjen e interesave të pajtimtarëve, gjykohet se do të sjellin si pasojë shkaktimin e një dëmi të rëndë e të pariparueshëm mbi interesat publike.

IV. Nga ana e Drejtorisë Juridike dhe Drejtoria e Rregullimit Ekonomik, pasi konstatohet se njoftimi me shkrim për mosmarrëveshjen, i cili përmban informacionin e kërkuar të përshkruar

në Shtojcën I të rregullores për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve, përputhet me përcaktimin e mosmarrëveshjes dhe informacioni i ofruar është i përshtatshëm, konsiderohet se përmbushen kushtet ligjore për pranimin e kërkesës dhe shqyrtimin e mosmarrëveshjes nga AKEP-i duke proceduar administrativisht, për këto arsye të dyja strukturat kanë propozuar marrjen e vendimit përkatës nga AKEP-i për këtë qëllim., sipas procedurës së parashikuar në nenin 120 të ligjit nr. 9918 dhe rregulloren 18/2010.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar, dhe nenit 46 e vijues, si dhe nenit 78 të KPrA,

VENDOS:

1. Të fillojë procedimin administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Albtelecom Sh.A., dhe Vodafone Albania Sh.A., duke pranuar kërkesën e depozituar nga sipërmarrësi Albtelecom Sh.A., me shkresë Nr. 5880 Prot., datë 25. 09. 2013 “*Kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje me Vodafone Albania*”.
2. Të urdhërojë masën e ndërmjetme për vazhdimin e marrëdhënieve midis Vodafone Albania dhe Albtelecom, lidhur me aksesin dhe tarifën e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin e Vodafone Albania sipas marrëveshjes midis palëve deri para lindjes së mosmarrëveshjes midis tyre (me dërgimin e shkresës së Vodafone Albania me CEO/113/MF, datë 16.09.2013), deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga AKEP-i për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.
3. Të ngrihet Komisioni për Zgjidhjen e mosmarrëveshjes me këtë përbërje:

• Altin	Rrapaj	Kryetar
• Jonida	Gjika	Anëtare
• Përparim	Bucaj	Anëtar
• Esmeralda	Dërvishi	Anëtare
• Filiola	Ristani	Anëtare
4. Ky vendim T’iu njoftohet palëve në mosmarrëveshje sipas përcaktimeve të KPrA.
5. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 diteve nga marrja e njoftimit të vendimit.
6. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E

Alketa MUKAVELATI

ANËTARË:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Benon PALOKA**
- 3. Elkeda DOMI**
- 4. Zamira NURÇE**